



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:152779

Datë: 21.09.2021

Numri i dokumentit: 02191821

P.nr.494/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit E. S.. nga Gj... për shkak të veprës penale asgjësimi, dëmtimi apo heqja e instalimeve publike nga neni 357 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.../2021, të datës 06.07.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 08.09.2021 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 21.09.2021 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri E. S.. nga babai Sh... dhe nëna F...., e lindur G..., i lindur me datë në fshatin K..., Komuna e N..... ndërsa me vendbanim në Gj..... rruga “V.... F..”, numër, i martuar, baba i ..fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në Kompaninë Ndërtimore “D...-Com” si k...., i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 12.07.2020, rreth orës 17:00 h, në Gjilan, në rrugën “Sh. S....U...”, në objektin në ndërtim e sipër “D...”, i pandehuri nga pakujdesia ka asgjësuar dhe dëmtuar instalimet publike në atë mënyrë që duke qenë punëtor i Kompanisë Ndërtimore “D...-Com” në ditë vikendi dhe pa dijeninë e pronarit të Kompanisë R....R...., shkon në firmën ndërtimore për të operuar me vinçin ngritës brenda vend punimit ku ishin duke u ndërtuar objektet banesore me ç’rast duke bartur ngjitës për fasadim rreth 700 kg nga pesha e rëndë vije deri tek këputja e spangos-sajllës dhe në këtë mënyrë nga rënia e ngarkesës dëmtohen kabllot e rrymës elektrike, rrjet i shtrirë për gjatë rrugës publike dhe për pasojë KEDS-it i shkakton dëm në vlerë të pa përcaktuar ndërsa banorët e lagjes për një kohë mbetën pa rryme.

-Me çka ka kryer veprën penale blerja, penale asgjësimi, dëmtimi apo heqja e instalimeve publike nga neni 357 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës të pandehurin E.S...:

E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara KEDS- Distrikti në Gjilan për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 12.07.2021 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.../2021 kundër të pandehurit E.. S... nga Gjilani për shkak të veprës penale asgjësimi, dëmtimi apo heqja e instalimeve publike nga neni 357 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.

Me datë 08.09.2021 pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezente prokurori i shtetit dhe i pandehuri ndërsa kishte munguar përfaqësuesi i të dëmtuarës KEDS i cili ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt nga ana e gjykatës ftesën e ka pranuar mirëpo mungesën e tij nuk e ka arsyetuar, me ç'rast pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri i lartcekur kishte deklaruar se e kishte kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se nuk ka nevojë për sqarime shtesë ndërsa sa i përket fajësisë i njëjti kishte deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës lëndore andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata në seancën e shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezente palët e lartcekura pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenin 248 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1-1.4 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e

ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 220-CA-..... të datës 12.07.2020, deklarata e dëshmitarit N.....S.. e dhënë para zyrtarëve policor me datë 12.07.2020, deklarata e dëshmitarit R.. R... e dhënë para zyrtarëve policor me datë 20.01.2021, raporti zyrtar i inspektoratit të punës i datës 24.08.2020, raporti i datës 12.07.2020 i hartuar nga Drejtoria e Inspektionit të Komunës së Gjilanit, certifikata e regjistrimit të biznesit N.N. “D....-Com” e datës 05.06.2019 e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, deklarata e të pandehurit E.... S..... e dhënë para zyrtarëve policor me datë 12.07.2020 dhe 15.06.2021, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes si dhe shkresat e tjera të lëndës gjithashtu gjykata me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartë cekurat gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i pandehuri Enver Selmani nga Gjilani ka kryer veprën penale asgjësimi, dëmtimi apo heqja e instalimeve publike nga neni 357 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës si në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij ashtu që me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ku mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit në të cilën përfshihet fakti se i njëjti veprën penale e ka kryer nga pakujdesia, pastaj gjykata pati parasysh sjelljen e mëparshme të kryesit për faktin se për të njëjtin ishte hera e parë që bie ndesh me ligjin, pranimin e fajit nga ana e të pandehurit si dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata gjithashtu pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata mori faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale përkatësisht i njëjti në çdo fazë të procedurës penale e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, pendimin e tij të cilin gjykata e mori si pendim të thellë dhe real, keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri për veprimet e tija, kërkim faljen e të pandehurit për veprën penale të shkaktuar nga ana e tij po ashtu gjykata si rrethanë lehtësuese për të pandehurin mori edhe rrethanat personale të pandehurit dhe karakterin e tij për faktin se

për të njejtin kjo ishte është hera e parë që bie ndesh me ligjin përkatësisht më parë nuk ka qenë i gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, i njejtë është mbajtës i familjes 6 anëtarëshe dhe është i vetmi i punësuar me të cilat të ardhura mban familjen rrethana këto të cilat tregojnë për një karakter të mirë të të pandehurit po ashtu gjykata si rrethanë për të pandehurin mori edhe premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa rrethanë rënduese për të pandehurin si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës gjykata nuk gjeti ndonjë andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 73 të KPRK-ës gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit ndërsa me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht përveç tjerash gjykata pati parasysh edhe qëllimin e dënimit me kusht i cili konsiston në atë se për veprat penale për të cilat parashihet dënim deri në 5 vite burgim vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme që të ndalojë kryesin të mos kryej vepra tjera penale.

5. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën KEDS Distrikti në Gjilan e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzetë euro) si shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.494/2021 me datë 21.09.2021

Numri i lëndës: 2021:152779
Datë: 21.09.2021
Numri i dokumentit: 02191821

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.